



BASHKIA LIBRAZH
Drejtoria e Bujqesise dhe Ushqimit

RELACION

MBI HARTIMIN E PROJEKT PREVENTIVAVE PER VEPRAT UJITASE QE DO TE RIKONSTRUKTOHEN NE VITIN 2019 DHE PERFITIMI NGA KETO INVESTIME.

Ne planin e investimeve, per punime ne veprat ujitese, ne vitin 2019 eshte planifikuar dhe jane hartuar projekt preventivat per objekte ujitese si me poshte:

- 1 – Rikonstrukcion Kanalit te Malit Hotolisht (loti I progresiv 255 – 2418 = 2163 ml) .**
- 2 – Rikonstrukcion Kanali Ujites Lunik – Zdrajsh Verri (loti dyte . Prusi – Zdrajsh Verri) me gjatesi 2613 ml.**
- 3 – Rikonstrukcion Kanali ne dalje te Ujembledhesit Vehcan me gjatesi 851 ml .**

1 – Me kryerjen e investimit “ikonstrukcion Kanalit te Malit Hotolisht” eshte studiuar dhe projektuar te rikonstruktohen 2163 ml nga 3500 ml qe eshte gjithsej kanali Mali Hotolisht.

Kanali Malit Hotolisht mbulon me ujitje rreth 230 ha dhe 224 fermere. Eshte nje veper ujitese e cila dominon tere fshatin Hotolisht. Per arsye se ky kanal kalon ne formacione shkembore e zhavorishte te filtrushme humbjet e ujit , ne pikun e ujitjes, jane teper te medha dhe sasia e ujit qe arrin ne fshat eshte shume e vogel dhe e pa mjaftueshme per nevojat e bujqesise. Per keto arsye u planifikua te futet ne planin e investimeve te vitit 2019. Punimet kosistojne ne seksionimin dhe veshjen me beton arme te pjeses me te madhe (2163 ml) te kanalit. Per vitin 2019 eshte planifikuar te punohet nga progresiv 255 deri ne progresiv 2418 sepse kjo eshte zona me problematike dhe me filtrime me te medha. Ne te ardhmen (loti dyte) eshte e nevojshme te kryhen punime ne pjesen e pare (ne marrje) me gjatesi 255 ml dhe ne pjesen fundore (ne hyrje te fshatit) ne gjatesi rreth 1250 ml, pra nga progresiv 2418 deri ne ate 3668. Me realizimin e ketyre punimeve problimi ujitjes se fshatit Hotolisht , me kete kanal , do te zgjidhet njehere e mire.

2 – Me kanalin Ujites Lunik- Zdrajsh Verri eshte mbuluar ujitja e fshatit Funares dhe Zdrajsh Verri.

Ky kanal ka mbuluar ujitjen ne 230 ha. Koha e gjate e shfrytezimit te ketij kanali , mirembajtja e pa mjaftushme dhe demtimet kane bere qe ky kanal te jete pak funksional per qellimin qe eshte ndertuar. Para nje viti eshte investuar ne pjesen e pare duke zgjidhur problemin per fshatin Funares kurse fshati Zdrajsh verri ka vite qe nuk merr asnje pike uje dhe mungesa e tij se cfar ndikimi jep ne bujqesi.

Per kete arsye u planifikua, u studjua dhe u projektua rikonstruksioni i pjese se dyte Prusi – Zdrajsh Verri me gjatesi 2613 ml. Me rikonstruksionin e kesaj pjese do te ujitin edhe 50 ha te tjere duke perfituar rreth 80 fermere.

Punimet per rikonstruksionin e ketij kanali kosistojne ne veshjen dhe suvatimin e tere pjeseve ku ka rrjedhe dhe filtrime uji. Ka perdorim te vogel vendosje tubacione sepse keto kane jete te shkurter perdorimi ne krahasim me punime betoni.

3 – Ne dalje te ujembledhesit Vehcan eshte nje kanal me gjatesi 851 ml i cili percjell ujin nga dalja e ujembledhesit deri ne hyrje te fshatit.

Zona ku kalon kanali eshte filtruese dhe per pasoje humbjet e ujit ne kete zone kane qene te medha sa qe ujitja nuk eshte bere e plote ne tokat qe mbulon kjo veper. Per kete arsye u planifikua dhe u projektua rikonstruksioni i ketij kanali i cili konsiston ne veshjen me beton ne tere gjatesine e tij . Me kryerjen e ketij rikonstruksioni do te permirsohet ujitja ne 130 ha duke perfituar rreth 165 fermere.

DREJTORIA BUJQESISE DHE USHQIMIT

DHJETOR 2018

